

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP
AGJ-04-235/20
viti 14.12.2020
SHKUP

Në bazë të nen.88 nga Ligji për gjykata ("Gazeta zyrtare e RM"nr. 58/2006, 35/2008, 150/10, 83/18, 198/18 dhe "Gazeta zyrtare të RMV nr.96/19), dhe nen.5 dhe 14 nga Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Shkupi II-Shkup 02.Agj.nr.59/15 të datës 26.06.2015, Rregullores për ndryshim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Shkupi II-Shkup 02.Agj. nr.88/15 të datës 01.12.2015, Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Shkupi II –Shkup 02. Agj.nr.52/15 të datës 26.07.2016, Rregullores për ndryshim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Shkupi II-Shkup 02. Agj.nr.8/18 të datës 17.01.2018 dhe Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Shkupi II Shkup 02. Agj.nr.9/19 të datës 06.02.2020, Kryetari i Gjykatës themelore civile Shkup, më datë 14.12.2020, solli :

V E N D I M

PËR STORNIM TË SHPALLJES INTERNE 1/2020 PËR AVANCIM TË NJË NËPUNËSI GJYQËSOR NË VENDIN E PUNËS UDHËHEQËS I SEKTORIT PËR INFORMATIKE, KATEGORIA B, NIVELI B-4

Shpallja interne 1/2020 për avancim të një nëpunësi gjyqësor në vendin e punës, Udhëheqës i sektorit për informatikë, Kategoria B, niveli B-4, e publikuar më datë 11.12.2020, **STORNOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata themelore civile Shkup më datë 11.12.2020 publikoi Shpallje interne 1/2020 për avancim të një nëpunësi gjyqësor në vendin e punës Udhëheqës i sektorit për informatikë, Kategoria B, niveli B-4. Në shpallje janë të theksuara kushtet, të cilat duhet ti plotësojnë kandidatët për këtë vend pune .

Më datë 11.12.2020, Administratori gjyqësor dorëzoi Njoftim AGJ-07-809/20 të datës 11.12.2020.

Në pajtim me Njoftimin e theksuar, në shpalljen e publikuar, një nga kushtet për avancim të nëpunësit gjyqësor në vendin e punës Udhëheqës i sektorit për informatikë, kategoria B, niveli B-4, është më së paku 4 vite përvojë pune në profesion.Megjithatë, në pajtim me nenin 10 dhe nenin 54 nga Rregullorja për ndryshim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Shkupi II- Shkup AGJ-02-9/19 të datës 06.02.2019, me të cilën bëhen ndryshime të nenit 5 dhe 14 në Rregulloren për

sistematizim që kanë të bëjnë me vendin konkret të punës, si përvojë e punës është e paraparë më së paku 4 vite përvojë pune në profesion pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

Në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në gjykatë në nenin 5, në Pasqyrën tabelare të kategorive, niveleve dhe emërtimeve të vendeve të punës, në pjesën II, "Kategoria B" NËPUNËS GJYQËSOR UDHËHEQËS, pika 7 dhe në nenin 14, janë paraparë edhe kushtet e veçanta për këtë vend pune dhe atë: më së paku 300 kredi të fituara sipas SEKT ose të ketë kryer shkallën VII/1, fakultet nga sfera e informatikës ose fakultet tjetër nga sfera përkatëse, më së paku 4 vite përvojë pune në profesion pas dhënies së provimit të jurisprudencës, njohje aktive të programeve kompjuteristike për punë në zyrë si dhe njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin europian (anglisht, frengjisht ose gjermanisht).

Duke i pasur parasysh dispozitat e theksuara, pas publikimit të shpalljes interne 1/2020 për avancim të një nëpunësi gjyqësor në vendin e punës Udhëheqës i sektorit të informatikës, kategoria B, niveli B-4, nuk mund të veprohet sepse është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në gjykatë.

Duke pasur parasysh këtë që u theksua, në rastin konkret bëhet fjalë për mangësi të cilat nuk mund të mënjanoreshin, me çka edhe vijoi që Kryetari i gjykatës të vendosë si në thenie .

GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP
KRYETAR
ILIR SULEJMANI

